



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrimit

Office of the Ministra

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Standardet e programeve për përgatitjen e mësimeve gjatë studimeve

NUMËR: MASHT 16/2005

DATË: 07.04.2005

Në bazë të nenit 1.3 pika ç) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë, nenit 12.4 të Ligjit mbi arsimin e lartë në Kosovë, nenit 12.5, nenit 32.1, të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me Statutin e Universitetit të Prishtinës, Udhëzimin administrativ për themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, Standardet e Praktikës Profesionale për mësimeve dhe Udhëzimin administrativ për Licencimin e mësimeve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që:

- a. Të përcaktojë kriteret për sigurimin e cilësisë së përgatitjes së mësimeve të Kosovës në mënyrë që shkollat dhe nxënësit të arrijnë qëllimet e arsimit të përgjithshëm .
- b. Të sigurojë që mësimeve të cilët diplomojnë në institucionet e akredituara për përgatitjen e mësimeve, të jenë të gatshëm të arrijnë standardet që parashihen me udhëzimin administrativ të MASHT-it – Standardet e Praktikës Profesionale.
- c. Të sigurojë që mësimeve të përgatitur në Institucionet e Kosovës të plotësojnë kushtet për licencim sipas kërkesave të Udhëzimit për Licencimin e Mësimeve dhe Administratorëve të nxjerrë nga MASHT-i.

- d. Të sigurojë që mësime të cilat diplomojnë në institucionet të cilat përgatisin mësime të përbushin kushtet për licencim në bazë të nenit 4 a) ,b) të Udhëzimit për Licencimin e mësimeve dhe administratorëve.
- e. Të sigurojë që Institucionet e akredituara për përgatitjen e mësimeve të zhvillojnë dhe t'u ofrojnë studentëve programe me përmbajtje dhe përgatitje pedagogjike sipas standardeve ndërkombëtare.
- f. Të sigurojë që të gjitha programet e institucioneve për përgatitjen e studentëve për mësime të përfshijnë programin për mësime praktik që do të zgjasë më së paku 22 javë gjatë kursit të programit të studimeve në përputhje me standardet.
- g. Të sigurojë që të gjitha programet për përgatitjen e mësimeve t'i plotësojnë minimumin e kërkesave të Deklaratës së Bolonjës.
- h. Të sigurojë që Institucionet e ndryshme për përgatitjen e mësimeve të kenë programe të harmonizuara¹, sipas standardeve të kërkuara.

Neni 2 Përfituesit

Nga ky udhëzim administrativ do të përfitojnë studentët që janë duke u shkolluar për mësime, nxënësit të cilët mësojnë nga mësime të përgatitur sipas standardeve të kësaj rregulloreje, prindërit dhe komunitetet.

Neni 3 Zhvillimi i Programeve

- 3.1. Institucionet e akredituara për përgatitjen e mësimeve janë përgjegjëse që të zhvillojnë programet sipas procedurave të vendosura nga Universiteti i Prishtinës dhe në pajtueshmëri me statutin, përfshirë edhe kërkesat e këtij udhëzimi.
- 3.2. Gjatë fazës së hartimit dhe zhvillimit të programeve rekomandohen konsultime ndërmjet institucioneve të autorizuara për përgatitjen e mësimeve.
- 3.3. Universiteti është përgjegjës për të siguruar që programet e aprovuara për përgatitjen e mësimeve të arrijnë standardet e përcaktuara me këtë udhëzim.
- 3.4. Mësime të cilat përgatiten nga institucionet për përgatitjen e mësimeve duhet të arrijnë Standardet e Praktikës Profesionale të mësimit me të diplomuar, kur edhe pranojnë përgjegjësitë e tyre të para për tu emëruar mësime në shkolla.

Neni 4 Përgatitja e mësimeve fillestar

- 4.1. Përgatitja për një mësime fillestar për licencim kërkon:

¹ "Harmonizimi " nuk nënkupton se programet janë identike

- a. Arsimim të përgjithshëm, përgatitje të mirëfilltë akademike në lëndët përkatëse, dhe studim të strategjive të mësimdhënies të fituara nga praktika efektive dhe nga hulumtime të vazhdueshme.
 - b. Në të gjitha programet në institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve duhet të kërkohet nga studentët që të përfundojnë me sukses kurse nga gjuha, letërsia dhe shkrimi në gjuhën e tyre amtare.
 - c. Përgatitja lëndore në programin fillor dhe atë parashkollor duhet të jetë e përgjithshme, do të thotë studentët duhet lejuar që të përfundojnë kurset bazë në disa fusha që lidhen me planprograme, si dhe në gjuhën amtare dhe në matematikë.
 - d. Programi për përgatitje lëndore për mësimdhënësit e shkollës së mesme të ulët duhet të aftësojë studentët që të mbajnë së paku dy lëndë nga planprogrami i miratuar i Kosovës.
 - e. Strategjitë e mësimdhënies duhet të sigurojnë qasje në kurse shtesë në psikologjinë e të nxënësve, psikologjinë e sjelljes dhe në metodologji të lëndëve përkatëse.
- 4.2. Përvojë cilësore në terren (së paku 22 javë gjatë katër viteve).
- 4.3. Përmbajtje të natyrës ligjore, etike dhe profesionale të mësimin .
- 4.4. Të sigurohet të mësuarit e gjuhës për një komunikim të mirëfilltë, njohuri nga matematika dhe të praktikohen shkathtësitë në marrëdhënie njerëzore dhe në shkathtësitë komunikuese.
- 4.5. Inkurajimi i një niveli të lartë të efikasitetit të studimeve në fakultete dhe zhvillimi i vetëdijes dhe etikës së shëndoshë në punë.
- 4.6. Për tu regjistruar në fakultetet për përgatitjen e mësimdhënësve, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e pranimit që do të jenë të barabarta me fakultetet tjera në universitet.
- 4.7. Studimet do të zgjasin katër vjet (8 semestra) që nga viti i regjistrimit.
- 4.8. Së paku gjysma e programit katërvjeçar të studimeve universitare të jenë të përbashkëta për të gjithë mësimdhënësit, pa marrë parasysh fushën e studimeve.

Neni 5

Aspektet e programit të studimit

- 5.1. Përmbajtja programore dhe procesi i përgatitjes së mësimdhënësve duhet të sigurojnë që të diplomuarit të posedojnë:
- 5.1.1. Njohuri socio-ekonomike, etnokulturore dhe diversitet gjinor me qëllim që të mund t'i përgjigjen në mënyrë efektive një diversiteti të tillë gjatë ushtrimit të mësimdhënies në ambientet shkollore.
 - 5.1.2. Njohuri për të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve dhe për Ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm (pasi që ka të bëjë me nxënësit).
 - 5.1.3. Njohuri dhe shkathtësi për t identifikuar dhe për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta, të jenë në gjendje të punojnë me nxënës me nevoja të lehta dhe të mesme, të cilët kanë aftësi të mësojnë në klasat e rregullta përmes një programi të modifikuar.

- 5.1.4. Njohuri dhe shkathtësi për të menaxhuar sjelljet e nxënësve në mënyrë që të ngrisë në maksimum nxënien e nxënësve duke iu shmangur dhunës dhe frikësimit në shkolla.
 - 5.1.5. Njohuri dhe shkathtësi në aplikimin e teknologjisë informative dhe të komunikimit për nxënien e nxënësve.
 - 5.1.6. Të kuptojë kompleksitetin e raportit të mjedisit shkollë-komunitet dhe veprimtarinë e përgjithshme të shkollave.
 - 5.1.7. Gatishmëri për bashkëpunim në procesin e punës.
 - 5.1.8. Motivim për ngritje të vazhdueshme profesionale.
- 5.2. Me aprovimin e senatit të universitetit, fakultetet e akredituara për përgatitjen e mësimit duhet t'i zhvillojnë programet në harmoni me politikat e Sektorit për Aftësimin e Mësimit të MASHT.

Neni 6

Implementimi

- 6.1. Universiteti duhet t'i sigurojë fakultetet që programet për përgatitjen e mësimit të fillojnë me kohë dhe të zhvillohen që nga fillimi i vitit akademik duke siguruar me kohë kuadrin e përshtatshëm.
- 6.2. Cilësia e mësimit të mësimit të përgatitur sipas këtyre programeve, ka rëndësi shumë të madhe. Institucionet për përgatitjen e mësimit duhet të shërbejnë si shembull i praktikës pedagogjike arsimore për fakultetet tjera.
- 6.3. Institucionet për përgatitjen e mësimit janë përgjegjëse për përgatitjen e programeve aftësuese, freskimin e tyre në harmoni me nevojat dhe kërkesat.
 - a) Në secilin vit akademik të sigurohet futja në zbatim e një lënde të re në secilin departament.
 - b) Të sigurohet freskimi i vazhdueshëm i të gjitha lëndëve me një përqindje të caktuar (10%) në çdo vit.
 - c) Të sigurohet një lëndë e përgjithshme e qasjeve të reja, e cila çdo vit fut nga një qasje (metodologji) tjetër të re në mësimit (qasja inkluzive, montesori, zgjidhja e konfliktit, puna grupore, e të tjera).
- 6.4. Institucionet për përgatitjen e mësimit, janë përgjegjëse për zhvillimin e partneritetit me shkolla për kryerjen e praktikës së mësimit si një komponent e rëndësishme e programit për përgatitjen e mësimit. Rrjedhimisht, ato duhet të zhvillojnë politika dhe programe të cilat:
 - a. Sigurojnë shkolla partnere të cilat kanë resurse të mjaftueshme njerëzore, interesim profesional dhe mjete të mësimit për të mbështetur një përvojë cilësore për studentët mësimit.
 - b. Të përzgjidhen mësimit mentorë të cilët kanë kualifikime të përcaktuara sipas Udhëzimit administrativ mbi Licencimin e mësimit dhe administratorëve.
 - c. T'u sigurojnë trajnim profesorëve dhe mësimit mentorë për mbikëqyrjen e komponentës së praktikës së mësimit.

- d. Të organizojnë praktikën e mësimdhënies në atë mënyrë që përvoja e tyre të fillojë me vëzhgim në fazën fillestare dhe gradualisht të sigurojnë që studentët me kohë të marrin përgjegjësi më të mëdha deri te përgjegjësia e plotë e mësimdhënies me të përfunduar të studimeve.
- e. Të sigurojnë vlerësim të arsyeshëm dhe korrekt të përvojës së praktikës së mësimdhënies duke ngritur gradualisht rezultatet në efikasitetin e studimeve konform progresit të studentëve gjatë programit.

Neni 7

Sigurimi i cilësisë

- 7.1. Programet për përgatitjen e mësimdhënësve duhet të vlerësohen çdo vit, me qëllim të përmirësimit të tyre, dhe duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi gjithëpërfshirës çdo 4 vjet.
- 7.2. Vlerësimi i brendshëm gjithëpërfshirës i programeve të fakultetit për përgatitjen e mësimdhënësve, brenda mundësive, duhet të bëhet në koordinim me vlerësimet e bëra nga Agjencia për Akreditim e Kosovës, sa herë që është e mundur.
- 7.3. Rishikimi i programeve do të duhej të bëhej sipas një vlerësimi të brendshëm të vet fakultetit, dhe do të pasonte me vlerësimin e jashtëm të bërë nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët vlerësojnë të arriturat (apo ngeçjet) e fakultetit dhe bëjnë rekomandime të nevojshme.
- 7.4. Vlerësimi i brendshëm i programit duhet të sigurojë dëshmi të cilat mundësojnë që konstatimet të dalin së pari nga procesi i rishikimit të brendshëm, e pastaj nga procesi i jashtëm përkitazi me efektshmërinë, efikasitetin dhe relevancën (rëndësinë). Të dy këto rishikime duhet të sigurojnë përgjigje në pyetjet në vijim (aneksi 1), dhe pyetje të tjera që mund të përpilohen për qëllim të ndonjë rishikimi të veçantë.
- 7.5. Me rishikimin e programeve të Institucioneve për përgatitjen e mësimdhënësve duhet të vlerësohet cilësia e programeve në bazë të nivelit të arritjes së standardeve në aspektin e efektshmërisë, efikasitetit dhe relevancës (shih Aneksi 1).

Neni 8

Hyrja në fuqi

Udhëzimi Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Agim Veliu, Minister

PYETJE PËR SHQYRTIM TË PROGRAMIT:

1. Efektshmëria

1. A është procesi i zgjedhjes së studentëve i barabartë me proceset e tilla që përdoren nga institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve në Evropë?
2. A kanë studentët gjatë studimeve në dispozicion stafin mësimdhënës, i cili ka dituri lidhur me praktikën aktuale shkollore dhe zhvillimet në praktikën e mësimdhënies në Kosovë, Evropë dhe vende të tjera?
3. A u sigurohen studentëve përshkrimet e kurseve, oraret e mësimit që respektohen nga profesorët, dhe informata lidhur me procedurat e vlerësimit?
4. Programi i mësimit praktik, a është i organizuar dhe i artikuluar mirë? A janë kërkesat nga studentët gjatë mësimit praktik të përshtatshme që studentët të zhvillojnë nivele të përvojës praktike? A e monitorojnë programin në mënyrë adekuate profesorët e fakultetit dhe shkollat partnere?
5. A matet, dhe a vlerësohet përparimi i studentëve në përputhje me praktikën universitare aktuale në Evropë?
6. A anketohen studentët rregullisht lidhur me cilësinë e punës së profesorëve të tyre? A merren masa adekuate të nevojshme lidhur me rezultatet e këtyre anketave?
7. A bëhet rishikimi vjetor i programeve për të bërë përmirësime në vitin vijues? A bazohen rishikimet e tilla në sisteme që përdoren në universitetet evropiane?
8. A janë në gjendje studentët të arrijnë Standardet e Praktikës Profesionale kur ata emërohen në detyra profesionale për herë të parë, sipas reflektimit nga rishikimet fillestare të efektshmërisë profesionale të tyre?
9. A anketohen rregullisht të diplomuarit nga ky fakultet lidhur me mendimet e tyre për përshtatshmërinë e programit në të cilin ata janë përgatitur për mësimdhënës (pas vitit 2007)? A është niveli i pëlqyeshmërisë 80% e më lartë?

2. Efikasiteti

1. A është procesi i zgjedhjes së studentëve mjaft rigoroz për të siguruar që shumica e studentëve të mbesin në program dhe të plotësojnë standardet e fakultetit si mësimdhënës në zhvillim? Kur në këtë proces ndodhin lëshime, a këshillohen studentët që të regjistrohen në fakultete të tjera?
2. Përqindja e studentëve që përsërisin, a është 10% e më pak në vit?

3. A diplomojnë 80% të studentëve brenda 6 viteve pas regjistrimit të tyre në fakultet?
4. Gjatë studimeve, a kanë studentët qasje adekuate në lokale të mësimi siç janë lloje të ndryshme të klasave dhe të sallave të mësimi, laboratorët, bibliotekat, qendrat për planprograme, kabinetet teknologjike dhe hapësirat për lexim/mësim?
5. A kanë studentët qasje në materiale mësimore cilësore të mjaftueshme në letër dhe përmes teknologjisë elektronike?

3. Relevanca (rëndësia)

1. A reflektohen në program kërkesat nga neni 3 pika 3.4 të kësaj rregulloreje?
2. A sigurojnë kurset dhe mësimi praktik në shkolla njohuri të thella dhe të kuptuarit e kërkesave nga neni 3 pika 3.5 i kësaj rregulloreje?
3. A përgatiten studentët në mënyrë adekuate për t'i plotësuar përgjegjësitë për mësimdhënie sipas planprogrameve mësimore të Kosovës, sipas mendimit të drejtorëve të anketuar të shkollave ?
4. A ka dëshmi që programi përtërihet rregullisht në përputhje me hulumtimet e zhvillimit të përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë, Evropë dhe vende të tjera?

4. Rishikimi i jashtëm

1. Raporti përmbledhës i ekipit për rishikimin e jashtëm duhet të komentojë lidhur me nivelin në të cilin Institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve plotësojnë kërkesat në vijim:
2. A i plotësojnë Institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve kërkesat e përgatitjes së mësimdhënësve sipas politikave të universitetit?
3. A i plotësojnë Institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve kërkesat e përgatitjes së mësimdhënësve sipas politikave të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës?
4. A i plotësojnë Institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve kërkesat që ia kanë përcaktuar vetes në vizionin, misionin, qëllimet, politikat, planet dhe programet?
5. A i plotësojnë Institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve kërkesat e kësaj rregulloreje?